

ZGJEDHJET
PËR KËSHILLIN
NACIONAL
TË PAKICËS
NACIONALE
SHQIPTARE



A e dini se si pjesëtarë i pakicës nacionale shqiptare mund drejtpërdrejt të ndikoni në zgjedhjen e anëtarëve të rinjë të Këshillit nacional të pakicave?

Zgjedhjet në të cilat do të zgjidhet përbërja e re e **Këshillit nacional të pakicës nacionale shqiptare do të mbahen më 4 Nëntor të vitit 2018**. Zgjedhjet do të jenë të drejtpërdrejta, që nënkupton që ju do të keni mundësi dhe të drejtë që këtë ditë të dilni në vendvotimet tuaja dhe të votoni për njërën prej listave zgjedhore të cilat marrin pjesë në zgjedhje.

Është me rëndësi të votoni në zgjedhjet që po vijjnë sepse Këshilli nacional është një organ i cili, përveç tjerash, ju përfaqëson Ju dhe pakicën nacionale shqiptare në sferën e **arsimit, informimit në gjuhën shqipe, kulturës dhe përdorimin zyrtar të gjuhës dhe shkrimit**. Kjo dmth që këshillit nacional **mund t'i drejtoheni për ndihmë** nëse keni çfarido problemi ose pengesa në lidhje me këto sfera.

Që të mund të votoni në zgjedhje dhe të zgjidhni anëtarët e këshillit të cilët do të Ju përfaqësojnë në jetën politike dhe publike, **me rëndësi është të keni njohuri me gjërat si vijojnë:**

- ▶ Duhet t'i keni mbi 18 vjet dhe të keni shtetësi të Republikës së Serbisë;
- ▶ **Duhet të jeni të regjistruar në Listën e veçant zgjedhore!** Lista e veçant zgjedhore përpilohet për çdo pakicë nacionale dhe për t'u regjistruar në të duhet që personalisht të shkoni në administratën tuaj lokale (në vendin ku jetoni) dhe të kërkonti **formularin për regjistrim në listën e veçant zgjedhore**. Për plotësimin e formularit ju nevojitet letërnjoftimi dhe 5 minuta kohë! Formularin e plotësuar ia dorëzoni shërbimit përkatës në komunë, i cili më pastaj do të kryej verifikimin e të dhënave. Nëse gjithçka do të jetë në rregull, Ju do të regjistroheni në Listën e veçant zgjedhore.
- ▶ **Afati për regjistrim ose ndryshimin e të dhënave në listën e veçant zgjedhore në Komunën Tuaj është deri më 31. Tetor.**
- ▶ Mund të dilni në votime, të mbushni fletën e votimit dhe të zgjidhni njerëzit të cilët do të Ju përfaqësojnë në Këshillin nacional.

Zgjedhjet për Këshill nacional organizohen **një herë në katër vite**. Radha tjetër kur do të mund të ndikoni në përbërjen e Këshillit nacional do të vie në vitin 2022. Mos e lëshoni mundësinë që të realizoni të drejtën e garantuar për të zgjedhur përfaqësues të mirë, kualitativ dhe të aftë që të jënë pjesë e përbërjes së një Organi që Ju përfaqëson Juve dhe i cili mundet të Ju ndihmoj në sfera të ndryshme.

Nëse keni ndonjë paqartësi në lidhje me zgjedhjet dhe procedurat zgjedhore, mund t'i drejtoheni CeSID-it në njërën prej mundësive: me email në **cesid@cesid.rs** ose në numrin e telefonit **011/407-56-05**.